

Editorial/

Ramazani, çelësi i dyerve të mirësisë

Nga hoxhë Sokol Kondakciu

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Prej urtësisë së Allahut të Madhëruar është dallimi disa vendeve nga disa të tjera dhe disa kohë nga kohët e tjera. Nga muajt ka veçuar muajin e Ramazanit dhe mund të themi se dallimi i tij krahasuar me muajt e tjerë është si planetet me diellin i cili i ndriçon ato. Këtë muaj Zoti ynë e ka pajisur me mirësi madhështore dhe veçanti të cilat nuk ia ka dhënë asnjë muaji tjetër. Ramazani është muaji në të cilin ka zbritur Kurani Famëlartë, jo vetëm kaq por në disa transmetime thuhet se në të njëjtin muaj janë zbritur dhe librat e shenjtë si Teurati dhe Ungjilli.

Muaji Ramazan është muaji në të cilin u bë obligim agjërimi, adhurim madhështor nëpërmjet të cilit fitohen përfitime madhështore në këtë botë dhe në botën tjetër. Ky muaj është muaji i faljes dhe i pastrimit nga mëkatet të cilat janë bërë gjatë vitit që nga Ramazani i kaluar. I dërguari ynë Muhamedi (alejhi selam) ka thënë në një thënie të transmetuar në përmbledhjen e Muslimit: *"Pesë namazet me to falen mëkatet që bëhen mes tyre, nga xhumaja në xhuma falen mëkatet që bëhen mes tyre, nga Ramazani në Ramazan falen mëkatet që janë bërë, nëse i shmangemi të mëdhave prej tyre"*.

Në një thënie tjetër profetike i Dërguari i Allahut thotë: *"Kush e agjëron muajin e Ramazanit me bindje ndaj Allahut dhe me shpresën tek shpërblimi i Tij, atij do t'i falen mëkatet e kaluara"*.

Përveç kësaj muaji Ramazan është muaji i përmirësimit të qenieve tona njerëzore, duke e pajisur atë me devotshmëri e duke e stolitur atë me sjelljet më të mira të cilat duhet t'i ketë çdo besimtar. Në Kurandin Famëlartë qëllimi i shpalljes të këtij obligimi



madhor është përsosja me devotshmëri. **"O ju që besoni është bërë për ju obligim agjërimi i Ramazanit ashtu sic ka qenë obligim dhe për popujt para jush me qëllim që të bëheni të devotshëm"**. (Bekare, 185) Në këtë muaj mbyllen dyert e Xhehenemit dhe hapen dyert e Xhenetit dhe djajtë prangosen me pranga dhe zinxhirë, çka tregon se është një muaj i jashtëzakonshëm për nga rëndësia e tij, po ashtu dhe rëndësia e punëve të mira që bëhen në të.

Devotshmëria është një gradë e lartë prej gradave të besimit tek Allahu i Madhëruar për të cilën duhet të përpiqet çdo njeri ta arrijë atë. Ajo është përsosmëria, është bindja dhe nënshtrimi total ndaj krijuesit Madhështor, nëpërmjet të cilës muslimani fiton emrin Evlija (i afërt i Allahut). Allahu i Madhëruar thotë në Kurandin: **"Evlija tek Allahu janë ata të cilët s'do ketë frikë për ta e asesi nuk do të jenë të dëshpëruar, janë ata që vërtetë besuan dhe kishin devotshmëri"**.

Në këtë mënyrë nëpërmjet devotshmërisë ai ka fituar kënaqësinë e Zotit të tij dhe është menjëherë nën mbrojtjen e Tij dhe kujdesin e Tij. Dëshirat dhe ëndrrat e tij do të realizohen shprehur në formën e lutjeve të përfuzuara dhe padyshim të pranuar, hallet dhe problemet e

tij do të marrin zgjidhje, sepse Allahu i Madhëruar asgjë nuk kursen për të, shpirti dhe zemra e tij do të jenë të qetësuar ngase ai e meriton të jetë i lumtur, armiku i tij do të jetë i mundur dhe i humbur, sepse ai është nën mbrojtjen dhe kujdesin të Plotfuqishmit, në dunja nuk i refuzohet gjë dhe Xhenetin e ka të siguruar. A ju duhen më tepër sesa këto?

Në një hadith kudsij Allahu i Madhëruar thotë: *"Kush lëndon një evlijaun Tim, Unë i shpall atij luftë, e rob i im nuk mund të afrohet tek Unë vetëm se nëpërmjet obligimeve, dhe ai vazhdon të afrohet tek Unë më shumë duke kryer dhe rite vullnetare deri sa Unë ta dua atë, e nëse e dua, këmba, dora dhe syri i tij do të jenë të mbrojtura nga vetë Unë (dhe ato nuk lëvizin vetëm se me pajtimin dhe kënaqësinë time). (Në këtë gradë) Nëse ai dë më kërkojë dicka patjetër që do ia jap atë, e nëse më kërkon mbrojtje patjetër që do ta mbroj atë."*

Duke u nisur nga sa përmendëm mund të themi se muaji Ramazan është një mysafir i përvitshëm, i cili nuk harron të na vizitojë dhe dhe të na shoqërojë me mirësitë e tij. Ai i ngjason një mysafiri të nderuar i cili kur vjen, vjen me duart mbushur plot dhuratat dhe mirësi për të cilat ne ia hapim dyert me kënaqësi. A mund të refuzohet nga njerëzit një muaj i tillë i cili në thelb ka edukimin dhe përsosjen e qënies

njerëzore nëpërmjet devotshmërisë, e cila nëse arrihet ajo vjen me mirësi pafund nga Zoti i gjithësisë?

Prej fryteve të devotshmërisë është zgjidhja e problemeve dhe shtimi i furnizimit nga Zoti ynë nga pasuria që nuk i mbaron kurrë.

Në Kurandin Famëlartë thuhet: **"Kush e arrin devotshmërinë ndaj Allahut, Allahu do t'i bëjë atij rrugëzgjdhje e do ta furnizojë atë me rizik nga ku nuk e pret"**.

Prej fryteve të devotshmërisë është gjithashtu lehtësimi i çështjeve të kësaj bote, siç thuhet në Kurandin e Lavdëruar: **"Kush e arrin devotshmërinë ndaj Allahut, Ai do t'ia lehtësojë atij çështjet"**.

Prej fryteve të devotshmërisë gjithashtu është fitimi i diturisë, mençurisë dhe i intuitës, e cila është shikimi përmes syrit të zemrës dhe kjo bëhet e mundur vetëm me dritën e besimit. Në Kurandin Famëlartë Zoti ynë thotë: **"Jini të devotshëm ndaj Allahut, që Ai t'ju japë dituri ju...."**.

Kjo devotshmëri është sekret i këtij obligimi madhor dhe gjithashtu çelësi i hapjes së shumë dyerve të hajrit dhe të mirësisë në jetën tonë. Andaj mund të themi se lumturinë në këtë botë mund ta arrijmë dhe po ashtu edhe garantimin e shpëtimit në botën tjetër, kjo nëpërmjet devotshmërisë tonë ndaj Allahut të Madhëruar, Krijuesit tonë Madhështor.

Atëherë, a mund të refuzohet ky muaj kaq i begatë e kaq madhështor i cili vjen rregullisht tek ne dhe enkas për ne me të gjitha ato mirësi që i përmendëm? A mundet që dikush të refuzojë dhuratat e mëdha që sjell ky muaj? Një mysafir të tillë askush nuk do ta refuzonte, të gjithë do t'ia hapnin dyert, ndaj hapjani dyert muajit Ramazan dhe ftojini të jetë i pranishëm në shtëpitë tuaja që ta ndryshoni jetën tuaj dhe të realizoni ëndrrat tuaja të mira e të gjeni lumturinë e humbur.

LHSH MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

Fq.3/ Jurisprudencë/ Dispozitat e kujdestarisë në Islam

..... Përktheu hoxhë Genc Plumbi

Fq.5/ Analizë/ Modeli i udhërrëfimit për ligjërimin e sotëm islam

..... Nga hoxhë Justinian Topulli

Fq.6/ Ramazan/ Itikafi në Ramazan

..... Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Fetva/

Akika dhe Iftari

Pyetje: Selam alejkum! A lejohet të bashkohet një akika me nijet iftari në kohën e iftarit?

Përgjigje: Shpërblimi i iftarit merret për dhënien e ushqimit dhe nuk ka lidhje me vetë ushqimin, se për çfarë qëllimi ai është bërë apo gatuar, kështu që nuk ka ndonjë problem i bashkimit në mes iftarit dhe akikes, sepse akika ka si synim "derdhjen e gjakut të kurbanit" ndërsa ftesa për ushqim është diçka më tepër.

Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH

Iftar në lokalin e një bektashiu

Pyetje: Selam alejkum! Desha të pyes për një rast që na ka ndodhur këtu në Gjirokastrë. Është bërë një iftar në një lokal që e ka një person që është bektashi dhe të varur në mur të lokalit ka fotografinë e një babai të teqesë. Lokali është i madh dhe ne jemi shtruar në një kënd të lokalit. Si i bëhet në këto raste, duhet të marrim pjesë në këtë iftar apo ta refuzojmë ftesën?

Përgjigje: Më e mira do ishte, për ata që bëjnë iftare, t'i bëjnë ato në lokalet e muslimanëve, po kështu dhe ai që ha apo pi nëpër lokale, të frekuentojë këto lokale, sepse kjo është edhe një ndihmë ekonomike për muslimanët. Në lokalet e tjera jo islame, nuk janë problem vetëm fotot e tilla, por ka edhe alkool, muzikë etj. Gjithsesi nëse bëhet një iftar në një vend të tillë, mendojmë se nuk është e ndaluar për muslimanin që të hajë në të, nëse pjesëmarrja e tij nuk nënkupton se ai mbështet këtë sekt apo është pjesë e tyre, si dhe nëse nuk ka ndalesa të tjera që kanë të bëjnë me ushqimin.

Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH

Kush e kompenson agjërimit

Pyetje: Një person, që e njoh personalisht, është shumë dembel në adhurime (namaz, agjërimit etj) falet me hope, por ai njehson Allahun. Është i sëmure, por jo në gjendje sa

të mos agjërojë dhe do që të japë kompensim, pra i bie shkurt (do ta kompensojë me ushqimin e një të varfëri), a i merret këtij personi ky kompensim apo jo? Ai thotë se nuk mundet se është me ilaçe? (Ka ca ilaçe të tensionit dhe është djalë i ri, nuk e merr mundimin të agjërojë dhe ta provojë një herë).

Përgjigje: Muslimani i cili e ka për detyrë të jap kompensim në ushqim për varfrit, në rast se ai nuk agjëron Ramazanin, është ai njeri që vuan nga një sëmundje e pashërueshme kronike, pra nuk shpresohet të shërohet, dhe agjërimi e dëmton atë apo i vë në rrezik jetën. Për këtë duhet marre parasysh edhe këshilla e mjekut specialist. Në të kundërt nëse sëmundja është e lehtë, ai duhet ta mbajë agjërimin, dhe vetëm e ndjen realisht se po e dëmton, atëherë mund ta prishe atë ditë dhe ta kompensojë me vone atë ditë me agjërim jashtë Ramazanit. Këtë gjë duhet ta kuptojë vetë i sëmuri, pra se kur e ka sëmundjen te lehtë, e kur e dëmton dukshëm atë (Esherhul mumti).

Nëse kompensimi jepet nga njëri që nuk plotëson atë përmendëm, atëherë ajo që ai jep nuk konsiderohet kompensim në realitet dhe nuk ia heq obligimin e agjërimit, sepse është një veprim që nuk kryhet në vendin e duhur, por ky veprim konsiderohet vetëm si sadaka.

Ky musliman duhet të këshillohet që ai të falet rregullisht, sepse namazi është shtylla e Islamit dhe gjëja e parë për të cilën do të pyetet njeriu në Ditën e Kijametit.

Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH

Mënyra e kompesimit të agjërimit

Pyetje: Një person që është musliman dhe do të agjërojë, por në pamundësi të shëndetit të tij të keq pra (është i sëmure dhe merr ilaçe). Do të japë kompensim pra të ushqejë të varfër si e jap këtë kompensim në lek apo ushqim? Sa? Dhe kur e jep (për çdo ditë, në fillim, apo në fund)?

Përgjigje: Kompensimi për shlyerjen e agjërimit jepet në ushqim, nga ata muslimanë që kanë sëmundje kronike ose janë të thyer në moshë dhe nuk mundin të agjërojnë. Nga

sahabi i nderuar Enes ibn Malik, (Allahu qofte i kënaqur prej tij!) përcillet se kur ai shkoi në moshë të thyer dhe e kishte të pamundur të agjëronte, grumbulloi tridhjetë të varfër në një ditë dhe u shtroi ushqim për të ngrënë.

Këtë njeriu kompensim i interesuar mund ta japë vetë ose mund të ngarkoj dikë tjetër për ta bërë këtë gjë për të.

Kompensimin mund ta japë për çdo ditë të Ramazanit, ose në fund të Ramazanit. Ai jepet në dy mënyra:

a) nga një vakt ushqim për aq ditë sa nuk ka agjëruar.

b) ose mund ta japë ushqim të pa gatuar (të paktën gjysmë sa, e barabartë kjo me masën e dy grushteve, prej artikujve ushqimor, si: oriz, fasule, etj., ose një grusht miell).

Kompensimi i agjërimit në pamundësi mund të jepet edhe në vlerë monetare, por me kusht që kjo vlerë të shkojë për ushqim. Kostoja e këtij ushqimi ndryshon në varësi të mundësisë ekonomike dhe ushqimit që konsumon vetë personi që duhet të japë kompensimin e agjërimit. Sipas një llogaritje të përafërt në lekë, në kohën që jetojmë, kjo shumë për ushqim të gatuar për Shqipërinë mund të shkojë së paku tek 250-300 lekë të reja, e mjaftueshme kjo për ushqimin një vakti të thjeshtë ngrënie për një njeri, kështu që për 30 vakte ushqimi shuma shkon në 8000 apo 9000 lekë të reja, por nëse kjo shumë jepet për blerjen e një ushqimi të pagatuar do të ishte më mirë, sepse i bie një sasi më e madhe dhe në këtë rast është ka më shumë interes për njerëzit nevojtarë.

Allahu e di më së miri!

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH

Hapja e restoranteve dhe e picerive gjatë kohës së agjërimit në ditët e Ramazanit

A lejohet hapja e restoranteve dhe picerive gjatë kohës së agjërimit në ditët e Ramazanit?

Përgjigje: Agjërimi i Ramazanit është detyrim për çdo musliman që ka plotësuar kriteret që parashtron feja islame për këtë obligim. Respektimi i shenjtërisë së këtij muaji është gjithashtu obligim për besimtarët, ndaj hapja e restoranteve, picerive dhe çdo lokali tjetër që ofron ushqim dhe pije si konsum i menjëhershëm gjatë ditëve të Ramazanit, është një çështje që ka të bëjë pikërisht me ruajtjen e shenjtërisë së muajit të Agjërimit.

Nisur nga detyrimi që ka çdo

musliman për të respektuar shenjtërinë e këtij muaji ne gjykojmë se nuk lejohet që këto lokale të mbahen hapur gjatë ditës, pra gjatë kohës kur kryhet agjërimi. Hapja dhe shërbimi i ushqimeve në to gjatë kohës së agjërimit konsiderohet bashkëpunim në gjynah, sepse u ofron ushqim atyre që e kanë detyrë të agjërojnë, paçka se shumë prej njerëzve e kanë vendosur të mos agjërojnë. Allahu i Madhëruar thotë: **"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi!"** (Maide, 2).

Po kështu hapja dhe servirja e ushqimit në këto lokale gjatë ditëve të agjërimit nga ana e muslimanëve jep një imazh jo të mirë në sytë e besimtarëve dhe të mbarë njerëzve.

Lejohet që këto lokale gjatë kohës së agjërimit të përgatisin ushqim, pica etj, nëse u kërkohet nga dikush që do t'i konsumojë ato pas iftarit, gjithashtu i lejohet të përgatisë ushqim me porosi nga ata persona që janë të arsyetuar dhe se kanë detyrë agjërimit siç janë udhëtarët, të sëmurët, pleqtë e thyer në moshë, fëmijët, gratë me cikël menstrual, etj. Ndërkohë lejohet përgatitja e ushqimeve para iftarit që të jenë të gatshme në kohën kur çelet iftari e më pas, për të gjithë kategoritë e njerëzve.

Ne këshillojmë që këtë ta bëni për hir të Allahut duke kërkuar shpërblimin e Tij dhe duke qenë të sigurtë se kush e lë diçka për hir të Allahut, Allahu do t'ia zëvendësojë me diçka më të mirë se ajo që ai ka lënë.

Allahu e di më së miri.

Komisioni i Pyetje-Përgjigjeve pranë LSHH



Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
رابطة أئمة ألبانيا
The Albanian Imam's League



www.lidjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidjahoxhallareve@yahoo.com

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri

lidjahoxhallareve@yahoo.com

Tel & Fax: +355 (0)48320160

http://www.lidjahoxhallareve.com

Jurisprudencë/ Dispozitat e kujdestarisë në Islam

Në thelb martesë është paqe në familje dhe vazhdimësi e dashurisë, por ndonjëherë ajo pëson krisje pas lindjes së disa konflikteve mes dy bashkëshortëve. Për këtë arsye Allahu i Lartësuar ka ligjëruar divorcin si një ilaç pas të gjitha përpjekjeve për mjekimin e martesës. Meqë Islami përkujdeset për brezat e tij, legjislacioni islam i ka dhënë një rëndësi të veçantë kujdestarisë së fëmijëve. Meqë kujdestaria është një problematikë që e hasim shpeshherë në realitetin e jetës së përditshme dhe shumë njerëz nuk kanë njohuritë e nevojshme rreth saj, duke i bërë ata që të konsumojnë shumë kohë nëpër gjykatat për zgjidhjen e kësaj problematike, ne do të përpiqemi që të sqarojmë disa dispozita që lidhen me të.

DOMETHËNIA E KUJDESTARISË

Juristët muslimanë e kanë përkufizuar kujdestarinë si një detyrim për edukimin e fëmijës dhe plotësimin e nevojave të tij në atë periudhë kohore që nuk mund të shmanget roli i grave që u takon ligjërisht e drejta për edukimin e fëmijës. Fëmija kalon në disa etapa gjatë fëmijërisë. Etapa e parë është ajo e vogëlisë, pra etapa kur fëmija nuk bën dallimin mes të mirës dhe të keqes. Etapa pasardhëse është ajo e dallimit mes të mirës dhe të keqes. Pra fëmija ose është në gjendje ta bëjë këtë dallim ose nuk është në gjendje. Si rrjedhojë dispozitat e kujdestarisë lidhen dhe ndryshojnë bashkë me ndryshimin e këtyre etapave.

ETAPAT E KUJDESTARISË

Etapa e parë:

Kjo etapa përfshin në periudhën që në lindjen e fëmijës deri në moshën e dallimit (mes të mirës dhe të keqes). Në këtë moshë është e drejtë absolute e grave që të mbajnë kujdestarinë e fëmijës, për arsye se në këtë moshë fëmija ka nevojë për dashuri dhe për një lloj përkujdesje që mund ta bëjnë realitet vetëm gratë. Nëna ka përparësi ndaj grave të tjera në këtë periudhë të jetës së fëmijës për shkak se ajo ka dhembshurinë dhe dashurinë e mjaftueshme për t'ia përcjellë fëmijës. Për këtë arsye, në këtë periudhë të jetës kujdestaria e fëmijës i takon nënës sipas pajtimit të gjithë juristëve muslimanë, përveç rasteve kur për shkaqe të caktuara i mohohet kujdestaria ose në rast se nëna heq dorë nga kjo e drejtë me vetëdije për t'ia kaluar atë ndonjë gruaje tjetër. Argumenti që tregon se kujdestaria i takon gruas në këtë periudhë është thënia e të dërguarit të Allahut (a.s.) drejtuar një gruaje: *"Ti e meriton më shumë nëse nuk martohesh."* Në këtë mënyrë ky hadith përcakton se martesë përbën një pengesë për marrjen e kujdestarisë nga nëna. Shejh Salih el Feuzan ka dhënë fetva se: "Nëse vajza është e vogël, apo fëmija mashkull ose femër është më i vogël se 7 vjeç dhe nëna e saj apo tij është e divorcuar, atëherë e drejta e përkujdesjes i takon asaj, vetëm nëse rast se ajo martohet me një burrë tjetër, atëherë fëmija kthehet tek babai i vet. E drejta e nënës për kujdestarinë e fëmijës së saj në këtë moshë është e detyrueshme. Në rast se gjendet dikush që përbush nevojat e fëmijës, atëherë i lejohet nënës që të heqë

dorë nga kujdestaria e fëmijës së saj. Në këtë mënyrë, nëse gruaja pranon të heqë dorë nga kujdestaria e fëmijës së saj në këmbim që burri t'i japë divorcin, atëherë divorci me privimin e të drejtës është i saktë, por kushti nuk është i saktë. Ebu Bekri r.a. gjykoj që Asimi, i biri i Omer bin Hatabit, të kalonte në kujdestarinë e nënës së vet dhe i tha Omerit: *"Aroma, era dhe butësia e saj është më e mirë për Asimin sesa ti."* Pra kujdestaria e nënës në këtë moshë është vendosur me pajtimin e dijetarëve.

Rregulli bazë i kujdestarisë në këtë moshë është koha e skadencës, me mbarimin e të cilës rrezohet edhe kujdestaria bazë dhe i kalon grave të tjera që janë në radhë. Shkaqet që rrezojnë kujdestarinë bazë, pra atë të nënës, janë sëmundja, pamundësia, martesë, mungesa e sigurisë për vogëlushin për shkak të keqrritjes apo mungesës së edukatës. Me rrëzimin e kujdestarisë së nënës në këtë moshë, kujdestaria nuk i kalon në mënyrë të drejtë për drejtë burrit, por i kalon grave të afërta me nënën, duke u nisur nga gruaja më e afërt me të. Kjo nuk e përjashton e marrëveshjen mes kujdestares dhe burrit që kujdestaria t'i kalojë atij.

Etapa e dytë:

Etapa e dytë quhet etapa e moshës së dallimit, pra në atë moshë kur fëmija arrin të kujdeset vetë për veten e tij; han, pin dhe vishet vetë. Disa dijetarë e kanë përcaktuar këtë periudhë në moshën 7 vjeçare për mashkullin, ndërsa moshë e dallimit për vajzën fillon kur ajo bëhet grua, që është moshë 9 vjeçare sipas një transmetim nga imam Ahmed. Kujdestaria e djalit në moshën e dallimit (midis së mirës dhe të keqes), sipas praktikës, fitohet duke e lënë të zgjedhë midis kujdestarisë së nënës dhe të babait. Në këtë formë kanë gjykuar një pjesë e halifëve të drejtë si Omeri, Aliu r.s. etj. Kështu ka gjykuar edhe Shurejh el Kadi. Është saktësuar se një grua shkoi tek i dërguari i Allahut (a.s.) dhe i tha: *"Burri im dëshiron të më marrë fëmijën..."* I dërguari i Allahut (a.s.) iu drejtuar fëmijës duke i thënë: *"Ky është babai yt dhe kjo është nëna jote. Merre prej dore kë të dëshirosh."* Fëmija kapi prej dorë nënën e tij dhe ajo u nis bashkë me të." Sahabet janë pajtuar për një gjykim të tillë. Amar el Xhermiju thotë: *"Aliu r.a. më la që të zgjidhja mes shaxhait dhe nënës sime kur isha në shtatë ose tetë vjeç."*

Një ndër parimet e konfirmuara në jurisprudencë dhe gjykim përpara i përket çështjes së zgjedhjes së fëmijës është se kjo mund të bëhet në rastet që mendohet se kështu realizohet interesi i fëmijës, sepse në rast se babai është më i garantuar për jetën e fëmijës dhe interesat e tij sesa nëna, atëherë ai ka përparësi karshi saj dhe në këtë rast nuk merret parasysh zgjedhja e fëmijës, sepse ai nuk është madhor dhe preferon më tepër shpërdorimin e kohës dhe lojërat. Si rrjedhojë, nëse fëmija zgjedh palën që ia siguron të tilla argëtime, atëherë zgjedhja e tij nuk merret parasysh, por zgjidhet pala që është më dobishme për të, sepse Allahu i Lartësuar thotë: **"O ju që keni besuar! Shpëtojeni veten dhe familjen tuaj nga zjarri, lënda e të cilit**

janë njerëzit dhe gurët." (Tahrim, 6).

E drejta e fëmijës për të zgjedhur mes palëve në këtë moshë nuk njihet vetëm në rast se të dyja palët janë në të njëjtin nivel përpara i përket mundësisë për t'u përkujdesur për të drejtat dhe nevojat e fëmijës, pra përzgjedhja e fëmijës nuk është një rregull absolut. Në rast se fëmija nuk zgjedh njërin prej tyre ose i zgjedh të dy, atëherë hidhet shorti. Në rast se shorti i bie nënës, por fëmija zgjedh babain atëherë i jepet babait. Nëse babai i fëmijës mashkull apo femër qoftë sëmurët, atëherë mund të kujdeset nëna për të, edhe pse ajo nuk është kujdestarja e fëmijës ligjërisht. Përpara i përket kujdestarisë së vajzës në këtë moshë, nisur nga praktika dhe mendimi i pjesës më të madhe të dijetarëve, ajo i takon babait për arsye se burrat janë më xhelozë për vajzat sesa gratë. Për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera legjislacioni islam e ka lënë martesën e vajzës në dorë të burrave të familjes dhe grave, si dhe nuk i ka dhënë nënës pushtet mbi veten e dhe pasurinë e vajzës.

Dijetari i nderuar Abdurrahman es-Sadi, kur është pyetur se kush e ka më të drejtën për kujdestarinë e vajzës pasi të ketë mbushur moshën shtatë vjeçare ai është përgjigjur: "Në medhhebin e imam Ahmedit njihet se kjo e drejtë i takon babait dhe në një transmetim tjetër thuhet për nënë, por nëse njëra palë neglizhon në kujdestarinë e fëmijës së vet dhe nuk ia plotëson nevojat e veta, atëherë kujdestaria e njëres palë bie dhe e merr pala tjetër. Mendimi im për qëndrimin me të përzgjedhur është që të shihet interesi më i mirë, për arsye se në këtë temë shihet me përparësi gjithmonë interesi i fëmijës."

Dijetari i nderuar Muhamed bin Ibrahim është pyetur për një vajzë në moshën tetë vjeçare për kujdestarinë e së cilës ka patur konflikte mes nënës së martuar me një burrë tjetër dhe vëllait të vajzës nga babai i parë, se cili prej tyre e meriton më tepër kundëstarinë e kësaj vajze? Shejhu (Allahu e mëshiroftë!) u përgjigj: "Përderisa nëna e kësaj vajze është martuar me një burrë tjetër, atëherë asaj i rrezohet e drejta për kujdestari, me argument hadithin e Profetit (a.s.): *"Ti e meriton më tepër nëse nuk martohesh."* Nëse vajza nuk ka një vëllai tjetër që e meriton më tepër se vëllai që ka kërkuar të drejtën e kujdestarisë, atëherë këtij të fundit i takon e drejta e kujdestarisë dhe zë vendin e babait të saj, nëse nuk ekziston ndonjë pengesë që ta fitojë këtë të drejtë, si p.sh. nëse është mendjelehtë apo njëri i prishur, ose ka një grua që nuk i përgjigjet nevojave të vajzës, e lëndon atë apo e neglizhon, atëherë nëna mund të fitojë të drejtën e kujdestarisë me miratimin e burrit të saj. Përpara i përket gjatë së dispozitës së ndërmjetme mes hadithit të Profetit a.s.: *"Ti e meriton më tepër nëse nuk martohesh"* dhe hadithit ku i dërguari i Allahut (a.s.) jep vendimin që kujdestarinë e vajzës së Hamzait r.a. ta marrë tezja e saj që ishte e martuar, dijetarët kanë dhënë disa mendime, ku më i sakti është ai që ka përmendur Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë!) se martesë e nënës me një burrë që është i afërt i fëmijës nuk e rrezon të drejtën e saj për kujdestarinë, ndërsa martesë e saj me një

burrë të huaj për vajzën e rrezon atë. Ky është qëndrimi më i njohur në medhhebin e imam Ahmedit.

Nëse vajza arrin në një moshë që është e pranueshme për martesë, atëherë ajo mbetet në kujdestarinë e atij që tregohet më xheloz për të dhe siç dihet që kryesisht baballarët nga natyra janë më tepër xhelozë për vajzat e veta sesa gratë, gjë e cila e nxit atë që të përpriqet më tepër për të ruajtur nderin e saj me të gjitha format. Nëse ne i japim përparësi njëri prej prindërve, duhet të marrim parasysh mundësinë e kujdesit dhe shërbimit ndaj fëmijës."

Së treti, kujdestaria e grave përfundon kur fëmija, mashkull apo femër qoftë, arrin në moshën e pubertetit dhe në këtë moment kujdestaria i kalon babait deri sa të arrihet moshë e pjekurisë për djalin dhe moshë e martesës për vajzën. Fëmija që ka arritur moshën e pjekurisë ka të drejtën që të zgjedhë të qëndrojë me prindin që dëshiron dhe nëse është mashkull ka të drejtën që të qëndrojë i pavarur prej tyre dhe nëse është vajzë nuk e ka këtë të drejtë vetëm se me lejen e babait të saj.

KUSHTET E KUJDESTARISË

- Nëna të mos jetë e martuar, sipas pajtimit të sahabeve dhe thënies së të dërguarit të Allahut (a.s.): *"Ti e meriton më tepër nëse nuk martohesh"*.

- Gruaja që merr kujdestarinë e fëmijës të ketë lidhje gjaku me të.

- Kujdestari të jetë madhor, i llogjikshëm dhe të ruajë amanetin. Në rastin e kujdestarisë kjo do të thotë që kujdestari të jetë në gjendje ta edukojë fëmijën dhe të përkujdeset për nevojat e tij.

- Dijetarët kushtëzojnë që feja e kujdestarit mashkull të përkojë me atë të fëmijës, ndërsa në rastin e kujdestares grua nuk kushtëzohet diçka e tillë, pra pranohet edhe në rastet kur feja e tyre ndryshon, deri në momentin kur fëmija të llogjikojë dhe të kuptojë fetë. Nëse feja e saj paraqet rrezik për fenë e fëmijës, atëherë i hiqet e drejta e kujdestarisë.

Këto janë kushtet që duhet të plotësojë një kujdestar dhe në rast se njëri prej këtyre kushteve nuk plotësohet, atëherë atij i mohohet e drejta e kujdestarisë duke kaluar tek pala tjetër që e meriton më tepër. Në lidhje me këtë temë ka shumë mendime, por mendimi më i goditur është se gratë e familjes janë më parësore se gratë e afërta me nënën, sepse realiteti ka provuar se fëmija lidhet më tepër me familjen e babait të vet. Nga ana tjetër ne besojmë se thelbesor është interesi i fëmijës dhe kujdesi për të. Për këtë qëllim është ligjëruar edhe kujdestaria. Përpara i përket rrëzimit të drejtës së nënës për të marrë kujdestarinë e fëmijës nëse është e martuar, një nga arsyet është fakti se legjislacioni islam ka marrë parasysh përkushtimin e gruas karshi bashkëshortit të saj dhe përplasjen e interesit të fëmijës me atë të bashkëshortit, gjë e cila mund të shkaktojë edhe ndërprejen e marrëdhënieve mes burrit dhe gruas. Ne i këshillojmë palët që synojnë marrjen e kujdestarisë së fëmijës që ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim dhe larg gjykatave duke larguar kështu pasojat negative që mund të përcjellë ky konflikt tek fëmija. Por në fund të fundit gjykata mbetet zgjidhja e fundit në rast se dështojnë të gjitha zgjidhjet që kanë në bazë mirëkuptimin dypalësh.

Përktheu: Hoxhë Genc Plumbi

Analizë/ MODELI I UDHËRRËFIMIT PËR LIGJËRIMIN E SOTËM ISLAM

Nga hoxhë Justinian Topulli

“Kjo kohë është koha e butësisë, durimit dhe urtësisë, nuk është koha e ashpërsisë. Shumica e njerëzve janë të paditur, të pavëmendshëm dhe të ndikuar nga kjo botë, ndaj duhet patjetër durim, duhet patjetër butësi, derisa tu mbërrijë thirrja islame, derisa tu komunikohet ajo njerëzve, derisa ata të mësojnë. Lusim Allahun për të gjithë që t’i udhëzojë.”

(Abdulaziz Ibën Bazi)



Jo pa qëllim e nisa këtë shkrim me fjalët e ish-Myftiut të Arabisë Saudite edhe pse padyshim fjalët e Allahut dhe Profetit të Tij qëndrojnë më lartë se fjalët e çdo qenie njerëzore. E nisa me fjalët e tij, që nuk kanë nevojë për koment, sepse ne si muslimanë, sot më shumë se kurrë kemi nevojë për modele të gjalla, që mishërojnë Fjalën e Allahut dhe të Profetit, sepse duket që leximi dhe mësimi përmendesh i tyre nuk mjaftojnë për të jetësuar praktikën islame në këtë kohë.

E nisa me fjalët e këtij hoxhe të nderuar, sepse është ndoshta një nga liderët e rrallë islam të kësaj epoke që ka bashkuar në personalitetin e tij pranimin dhe respektin edhe të atyre që nuk i përkisnin të njëjtës shkollë si ai.

E nisa me fjalët e këtij dietari, sepse rrallë kush si ai mund të identifikohet sot si imami më i pranuar dhe i vlerësuar, në mesin e atyre që etiketohen sot si vehabi apo konsiderohen selefi.

Ibën Bazi –siç i thërrisnin atij shkurtishte pra udhërrëfyti më i pranuar i atyre që sot më shumë se kushdo mes muslimanëve konsiderohen si më radikalët, fanatikët dhe ekstremistët e muslimanëve.

E nisa me këto fjalë, sepse neve sot na mungon shpesh ky dimension që ky njeri na e përçon me këto fjalë të thjeshta, por edhe me personalitetin

e tij, që mbase përtej emrit të tij, shumë pak ndoshta ia njohin shumë prej atyre që në fakt e vlerësojnë atë si një nga Imamët e kohës sonë. Unë pikërisht ua drejtojë atyre këtë shkrim edhe pse absolutisht nuk u mbaj ison llogapeve të padrejta, që neve na vijnë nga dashakeqësia apo padija e njerëzve.

Është më se e pritshme, që pas këtij rigjallërimi religjioz dhe deshëkullarizimi të jetës publike që ka pushtuar sot mbarë botën islame, të

vërshojnë ndaj muslimanëve akuzat, klishet dhe paragjykimet e vjetra, si nga jashtë ashtu dhe nga brenda saj.

Në një botë të tillë liberale si kjo e sotmja është normale që akuza më e lakuar ndaj fetarëve të jetë ekstremizmi, fanatizmi dhe radikalizmi. Ndaj kjo nuk ka pse na habit. Unë nuk dua të ndalem tani tek ky problem i tyre, por te pjesa jonë, që pa dorashka do ta quaja me plot gojën e gabuar.

Ne duhet të kemi guximin të pranojmë mes nesh gabimet tona dhe dashakeqësia e padija e të tjerëve nuk duhet të na verbojë për të kuptuar pjesën tonë të fajit, sado e madhe apo e vogël qoftë ajo. Ky është morali i një besimtari të vërtetë, që sheh më parë veten e tij për të korrigjuar sesa të tjerët.

Bota e sotme islame në pjesën më të madhe të saj vuan nga mjerimi ekonomik, nga pushtete të padrejta politike, nga qeverisje të korruptuara në plot kuptimin e fjalës, nga shtypje dhe padrejtësi të panumërta, dhe gjithashtu edhe nga një indiferencë e qëllimshme dhe qëndrime aspak të drejta nga ana e perëndimit, që trembet prej saj dhe nuk është çliruar akoma nga klishetë e vjetra të mesjetës, që ka për këtë pjesë të botës dhe për këta njerëz.

Në një situatë të tillë armiku i këtyre popujve shihet si i dyfishtë, ai brendshmi, që shihet si shërbëtor dhe servil i botës së huaj, si një zullumqarë

që jeton me bekimin e jashtëm dhe natyrisht ai i jashtëm, që shihet si përgjegjësi kryesor dhe i parë i gjendjes së mjeruar aktuale ku jetojnë muslimanët. Përkundrejt kësaj Islami, si pjesë e pandarë e identitetit të këtyre popujve dhe më i qëndrueshmi dhe më frymëzuesi, është bërë arma më e fuqishme për të luftuar këtë gjendje. Për shumë arsye sociale e kulturore, por jo të vetmet, feja është bërë i vetmi burim i qëndrueshëm dhe më i fuqishmi, që mobilizon më shumë se çdo gjë tjetër popujt e vendeve muslimane për ndryshime politike, ekonomike dhe sociale. Si rezultat i kësaj, rigjallërimi islam në këto vende, krahas rolit predikues që kanë luajtur hoxhallarët dhe liderët e ndryshëm fetar, në formimin dhe ngjyrimin e tij ka pasur një rol të rëndësishëm edhe gjendja sociale, kulturore, ekonomike e pleksur kjo me dëshirën për të dalë sa më parë dhe me çdo mjet nga një situatë e tillë. Është pikërisht kjo mungesë durimi, e deri diku edhe ndikimet e frymëzimeve revolucionare antikapitaliste, që kanë kapluar një periudhë kohë botën islame, disa nga faktorët kryesorë që e kanë e kanë ngjyrosur me ashpërsi në ligjërim dhe në veprime, një pjesë të rigjallërimit islam, që në fakt është një rigjallërim që në gjerësinë e tij buron nga nevoja e patjetërsueshme e njeriut për të jetuar me dhe në besimin e Zotit. Dhe të dyja këto arsye shkaktohen nga mosnjohja e mirë e Islamit dhe mungesa e edukimit nëpërmjet modeleve aktuale të gjalla islame.

Njeriu në natyrën e tij është i prirë të reagojë dhunshëm ndaj padrejtësive ekstreme, shtypjes, përçmimit, fyerjes, vrasjeve dhe çdo gjëje të keqe që sundon dhe shpalolet në mënyrë të skajshme.

Gjendja në të cilën jetonin muslimanët e parë në Mekë nuk ishte aspak më e mirë dhe kishte mjaft motive për të shpërthyer, dhe ne e dimë që ishte pikërisht dhuna ekstreme ajo që i detyroj muslimanët të emigronin nga ai vend. Por ndërkohë gjendja fetare, morale dhe sociale nuk ishte aspak më e mirë, ajo përshkruhet mjaft mirë nga fjalët e Xhafer ibn Ebi Talibit para mbretit të Abisinisë ku ai tha:

“O mbret! Ne ishim njerëz të zhytur në injorancë. Adhuronim idhujt, hanim mishin e kafshëve të ngordhura, bënim imoralitet, nuk respektonim lidhjet farefisnore, silleshim keq me fqinjët, i fortë mes nesh e hante të dobët.”

Pra motivimi ishte i dyfishtë për të reaguar ashpërsisht, qoftë edhe e

kufizuar në gjuhën verbale të fjalës, por kjo nuk ndodhi asnjëherë. Dhe cila qe arsyeja? Pikërisht po të njëjtat arsye që përmend Ibën Bazi për kohën e sotme.

Padija e theksuar dhe keqinformimi i madh që ekziston ndaj fesë sot dhe në veçanti ndaj Islamit dhe muslimanëve, nuk është kurrsesi arsye për të shpërthyer në një hakmarrje verbale apo fizike. Veprime të tilla janë mungesë e durimit dhe mbi të gjitha mungesë e dijes dhe thelbit fetar islam si dhe e edukimit të mirëfilltë islam.

Të gjithëve ne që lexojmë Kuranin na kujtohet historia e Musait, Profetit të Zotit, dhe Faraonit të Egjiptit. Dhe përkundrejt të gjitha limiteve që ky mbret i padrejtë kishte kaluar, kundrejt vetë Zotit dhe njerëzve, Allahu e urdhëron Musain dhe të vëllain e tij që ti drejtohen këtij njeriu me fjalë të buta! Kjo pikërisht sepse ai dhe populli i tij ishin zhytur në atë masë injorance sa vetëm fjala e butë dhe e dhembshur mund të bënte efekt, në ato zemra të nxira dhe të tjetërsuara plotësisht. Njerëzit mes të cilëve ne jetojmë sot nuk janë në gjendje morale dhe fetare më të mirë sesa këta popuj që na vijnë si shembuj nga historia, ndaj dhe këta kanë të njëjtën nevojë për butësi, dhembshuri dhe mëshirë si ata njerëz, analogjia në këtë rast është më se me vend.

Ishte Profeti i Allahut, Muhamedi (alejhi salatu ue selam), ai që sanksionoi për ne në çdo kohë se cila duhet të jetë gjuha e ligjërimin tonë islam, cila duhet të jetë gjuha e predikimit në mes njerëzve të tillë, të zhytur në padijen e mosnjohjes së fesë. Ai thoshte:

“Allahu është i butë dhe e do të butën në çdo çështje. Kudo që gjendet butësia, ajo gjë shkon për bukuri dhe kudo ku ajo mungon ajo shëmtohet” (Muslimi).

“Lehtësoni dhe mos vështirësoni, përgëzoni dhe mos i largoni njerëzit” (Muslimi).

Kjo vlen si rregull i përgjithshëm për mbarë njerëzit, sepse është pikërisht padija, qoftë kjo nga mungesa e informacionit apo nga informacioni i gabuar, shkaku kryesor i antipatisë dhe armiqësisë së njerëzve ndaj nesh dhe Islamit. Kur Profetin tonë e goditën me gurë dhe e gjakosën kokë e këmbë, ai nuk tha se ata ishin njerëz që motivoheshin nga dashakeqësia dhe intriga e parisë që i shtynte, edhe pse ishte kështu, por ai pa arsyen e vërtetë dhe kryesore të kësaj sjellje të padenjë që ishte padija e tyre, ndaj dhe

Shoqëri/ Një ligj ndërkombëtar kundër islamofobisë

Në vitet e fundit janë publikuar disa tregues tepër të rrezikshëm për stabilitetin njerëzor dhe që nxisin edhe më shumë urrejtjen mes itharëve të feve. Lëvizjet anti-islamike janë shtuar dukshëm në të gjithë botën, duke përfshirë këtu edhe vendet demokratike që bëjnë thirrje për respektimin e feve. Duke filluar nga gazeta daneze që botoi karikaturat që ofendonin Profetin (a.s.), duke vazhduar tek prifti amerikan që bëri thirrje për djegien e Kuranit me rastin e ditës përkujtimore të sulmeve të 11 Shtatorit 2001 dhe duke përfunduar me thirrjet që akuzojnë Islamit si fe e terrorizmit dhe ekstemizmit, e shumë e histori e ngjarje të tjera që ndodhin këtu dhe aty...

Këto ngjarje dhe kjo valë e urrejtjes anti-islamike në rritje duhet që domosdo që të nxisi muslimanin që të mendohet thellë dhe të ndërmarrë hapa që kanë për synin parandalimin e këtyre sulmeve dhe pakësimit të tyre sa të jetë e mundur. Prej këtu lindi ideja e projektit “*Ndalimi i armiqësisë ndaj Islamit dhe simboleve të tij të shenjta*” për të mbërritur kështu në nxjerrjen e një ligji ndërkombëtar që të ndalojë apo të kriminalizojë çdo armiqësi kundër fesë islame dhe kundër çdo simboli apo objekteve të shenjta që lidhen me të. Këto simbole dhe vende të shenjta do të përcaktohen më vonë në detajet e këtij ligji.

Sigurisht që një punë e tillë ka nevojë për përpjekje në nivel individësh, institucionesh dhe deri shtetesh. Kjo arrihet përmes diskutimeve të shumta rreth çështjes së armiqësisë kundër Islamit përmes marëdhënieve dypalëshe, përmes bashkëpunimit mes organizatave dhe strukturave të ndryshme ndërkombëtare.

Është me rëndësi të thuhet se ky projekt është përkthimi i realist i realitetit të sotëm me fenë islame dhe simboleve të saj të shenjta. Si rrjedhojë ky projekt pasqyron shqetësimin e madh në lidhje me rritjen e dhunës kundër Islamit në botën perëndimore, sidomos në Amerikë dhe Evropë, pa neglizhuar rëndësinë e dokumentimit të kësaj dukurie me shumë kujdes, për arsye se lëvizjet anti-islame marrin forma të ndryshme për të deformuar realitetin e kësaj feje

dhe të ithatërëve të saj, madje edhe për të nxitur dhunë kundër saj. Sigurisht kjo nuk është e thjeshtë deri në atë masë që ky projekt të fitojë përkrahjen dhe mirëkuptimin rajonal, por si fillim ky është hapi i parë për të forcuar ecurinë e këtij projekti dhe më tej duke e zgjeruar përkrahjen dhe ndërgjegjësimin për të përfshirë gjithë botën islame dhe më pas gjithë botën.

Për ta bërë edhe më të kuptueshme këtë ide, shembulli më i qartë është ligji që dënonin anti-semitizmin, i cili është pranuar në shumë vende të botës, i cili ndalon dhe ndëshkon qoftë edhe atë që dyshon rreth Holokaustit në periudhën hitleriane në vitet të dyzet të shekullit që kaloi, shtu këtu edhe përfshirjen e çdo veprë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë që nxit urrejtjen apo armiqësinë kundër çifutëve si popull apo jehudizmit si fe apo cënimit të vendeve të shenjta të çifutëve. Pra çështja është e qartë. Kjo botë sot ecën sipas marrëveshjeve dhe traktateve, edhe nëse pjesë e saj mund t'i thyejë ato, por në shumicën e rasteve pjesa më e madhe e ligjeve janë të dobishme dhe mund të përfitohet prej tyre. Ky projekt ka nevojë që të ketë pajtimin e botës islame fillimisht, në mënyrë që të mos ketë asnjë kontradiktë rreth tij. Kjo arrihet së pari duke përcaktuar me saktësi objektivin që kërkohet dhe pa u zgjeruar pa nevojë. Atëherë mund të themi se ky projekt synon ndëshkimin e çdo veprë që ofendon fenë islame, ose Profetin (a.s.), ose Kuranin Famëlartë. Çdo gjë tjetër përveç kësaj nuk përfshihet në këtë projekt, për arsye se mospajtimet e mendimeve në fushën islame janë të shumta. Me rëndësi është të theksojmë se ky ligj nuk është kundra askujt, qoftë individ, popull, organizatë apo shtet. Përkundrazi, ky projekt nisat nga synimi për të ruajtur autoritetin dhe madhësinë e një feje qiellore si Islami dhe ruajtjen e parimeve, simboleve dhe objekteve të shenjta të tij nga çdo poshtërim apo nga çdo thirrje direkte ose indirekte kundra tij dhe nga çdo provokim i armiqësisë dhe urrejtjes midis popujve dhe civilizimeve.

islamonline.net/ar/1975

Islamophobia



Vijon nga faqja 4

iu lut Allahut duke thënë: “O Zot! Fale popullin tim se nuk dinë se çfarë bëjnë!”

Kjo do të thotë se realiteti i sotëm është një lloj me paragjykime negative, më së shumti për shkak të padijes dhe dezinformimit, sesa për shkak të dashakeqësisë individuale të njerëzve. Dhe këtë e provon mjaft mirë fakti se nuk janë të pakët ata njerëz që pasi njohin Islamit e pranojnë atë edhe pse deri dje çfarë nuk besonin për të dhe muslimanët.

Por, edhe për ata dashakeqës dhe zullumqarë, që e njohin mirë Islamit dhe tremben prej tij nga motive fetare apo të tjera, dhe që realisht nuk janë shumë, Kurani nakaudhëzuar mënyrën sesi duhet të sillemi, por pa përdorur ndërkohë aspak dhunë verbale apo fizike. Allahu thotë në mësimin e Tij të përjetshëm: “**Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë. Dhe thoni: “Ne besojmë në atë që na është zbritur neve dhe në atë që ju është zbritur juve. Zoti ynë është një – dhe ne Atij i nënshtrohemi si musimanë.”** (El-Ankebutë, 46)

Të gjitha këto fjalë nuk janë thirrje aspak për të mohuar xhihadin, si element i pamohueshëm i fesë që ne kemi, por për ta vendosur atë në kontekstin dhe vendin e duhur. Xhihadi ynë në këtë vend dhe në mesin e këtyre njerëzve që na rrethojnë nuk është dhuna verbale në faqet dhe komentet e internetit, as gjuha kërcënuese dhe britmat në hutbet e xhumasë dhe në mësimet që mbahen në xhami, por ajo që bëri Profeti në Mekë, siç e përshkruan Xhaferi në bisedën e tij që cituam më sipër:

“Profeti na ftoi tek Allahu, që ta njësojmë dhe adhurojmë Atë. Të braktisim atë që adhuronin baballarët tanë, veç Tij, gurët dhe idhujt. Na urdhëroi të flasim të vërtetën, të mbajmë fjalën e dhënë, të ruajmë lidhjet farefisnore, të sillemi mirë me fqinjët, të mos prekin gjërat e ndaluara dhe gjakun e njerëzve, të mos mashtrujmë, të mos përvetësojmë pasurinë e jetimit, të mos shpifim për gratë e ndershme. Na urdhëroi të adhurojmë vetëm Allahun e pashoq, e pa ortakëri në asgjë, na urdhëroi të falemë, të japim zekatin dhe të agjërojmë...”

Dhe e gjitha kjo tregon se ne nuk duhet ti bëjmë lajka rendit politik, social dhe kulturor që na rrethon për të këqijat që ka, dhe as ta miratojmë atë, por në fund të fundit kjo do të thotë qartë se ligjërimi ynë qoftë kritikë, mbrojtës ose predikues nuk duhet të jetë kurrësi ai i ashpërsisë dhe i dhunës verbale. Nëse ne e konsiderojmë veten si njerëzit më të mirë të kësaj bote, jo për shkak të racës apo ngjyrës, por për shkak të asaj që ne besojmë dhe bëjmë, nuk duhet të harrojmë se kjo mirësi meritohet duke qenë njerëzit më të mëshirshëm me njerëzit e tjerë, sepse ai që njeh të vërtetën i tillë duhet të jetë.

Islami është melhem për plagët e njerëzve, dhe nga ata melheme që veprojnë në kohë dhe shërojnë pa të djegur dhe pa shkakuar dëme anësore. Trajtimi me mëshirë dhe dhembshuri i njerëzve nga ana jonë si muslimanë flet për masën e durimit tonë dhe dëshirës, që këta njerëz të njohin të mirën dhe të vërtetën.

ITIKAFI NË RAMAZAN

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

Itikaf nga ana gjuhësore do të thotë të qëndrosh mbyllur në një vend, ndërsa në gjuhën e shariatit Islam do të thotë të qëndrosh për një kohë të caktuar brenda në xhami duke bërë adhurime. Imam Ibn Kajjim El-Xheuzije, në librin e tij “Zadul mead” thotë: “Qëllimi i itikafit është të lidhësh zemrën me Allahun, duke u vetmuar me Të me adhurime, si dhe duke i ndërprerë lidhjet me krijesat.”

Koha e itikafit nuk është e përcaktuar, mund të qëndrohet për një kohë të shkurtër ose të gjatë, sipas nijetit. Prej sunetit (Traditës Profetike) është të qëndrohet në itikaf 10 ditët e fundit të Ramazanit bashkë me netët e tyre, sepse në to gjendet nata e Kadrit. Profeti (alejhi selam) ka hyrë në itikaf në xhaminë e tij çdo Ramazan 10 ditët e fundit, ndërsa në vitin në të cilin ka ndërruar jetë ka hyrë në itikaf 20 ditët e fundit, siç përcillet kjo nga Buhariu.

Itikafi mund të bëhet në çdo xhami në të cilën falet xhumaja dhe pesë namazet e ditës me xhemat. Gjatë itikafit nuk mund të dilet nga xhamia, vetëm nëse është e nevojshme. Gjatë itikafit besimtari duhet të bëjë sa më shumë adhurime, të falë namaze vullnetare, të këndojë Kuran, të përmendë Allahun sa më shumë, të kërkojë falje për gjynahet dhe t'i drejtohet Atij me lutje të ndryshme.

Itikafi lejohet të bëhet edhe nga gratë. Çdo grua që dëshiron të qëndrojë në itikaf brenda në xhami është e lirë ta bëjë këtë. Aishja r.a ka thënë: “Profeti (alejhi selam) ka qëndruar në itikaf për çdo Ramazan në 10 ditëshin e fundit, derisa ndërroi jetë, pas vdekjes së tij kanë qëndruar gratë e tij në itikaf.” (Buhariu & Muslimi)

Çdo musliman që futet në itikaf i lejohet të hajë, të pijë dhe të flejë në xhami gjatë kohës së itikafit, por duhet të ketë kujdes të ruajë pastërtinë, rregullin dhe respektin e xhamisë si vend adhurimi. Duhet të kemi parasysh edhe diçka tepër të rëndësishme. Nuk lejohet që burri ose gruaja të qëndrojë në itikaf dhe të lërë mënjanë detyrimet dhe përkujdesjen ndaj familjes, sepse itikafi është sunet, ndërsa kujdesja për familjen është vaxhib (detyrë). Nëse mund të bëhet edhe vaxhibi edhe suneti, atëherë ajo është mirësi e madhe.

NATA E KADRIT

Nata e Kadrit është nata më e mirë e gjithë vitit. Allahu i Lartmadhëruar thotë në Kuran: “**Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj**” (El Kadër, 3). Pra puna në këtë natë si namazi, leximi i Kuranit, dhikri është më e mirë se puna e një mijë muajve. Në këtë natë përcaktohen të gjitha fatet e njeriut për një vit.

Është e pëlqyeshme që të kërkohet kjo natë në netët teke të dhjetëditëshit të fundit të muajit Ramazan. Prej traditës profetike është që këto netët të kalohen zgjuar me adhurime për të arritur vlerën dhe mirësitë e shumta që zbret Allahu i Lartësuar në këtë natë. Profeti (alejhi selam) thotë: “Kush nuk e arrin Natën e Kadrit, vërtet ai është i privuar nga mirësitë e saj.” Pikërisht për këtë është e pëlqyeshme që ne të jemi vigjilent me adhurime dhe lutje të ndryshme në të gjithë dhjetëditëshin e fundit nëse vërtet duam të arrimë Natën e Kadrit. Andaj kjo çështje nuk duhet neglizhuar, sepse ai që neglizhon në Natën e Kadrit është ai që e meriton humbjen.

Në cilën natë të këtij muaji është ajo?

Dijetarët islam kanë mendime të ndryshme për këtë çështje. Dikush prej tyre mendon se ajo është natën e njëzet e një, dikush mendon se është në natën e njëzet e tretë, dikush mendon se është në natën e njëzetepesë dhe dikush në të njëzetentën. Por një numër i konsiderueshëm mendojnë se ajo lëviz nga viti në vit. Pra, një vit mund të jetë në të njëzetentën dhe në vitin tjetër mund të jetë në një natë tjetër. Disa të tjerë mendojnë se ajo është në natën e njëzet e shtatë. Ndër këta është ibn Abasi dhe Ubej ibnu Ka'b. Pejgamberi (alejhi selam) ka thënë: “Kush do që ta kërkojë atë le ta kërkojë në natën e njëzeteshtatë” (Transmeton Ahmed).
Ubej ibn Ka'bi betohej dhe thoshte se ajo është në natën që na urdhëroi Pejgamberi që të bëjmë ibadet në të, ajo është e njëzeteshtata. (Transmeton Muslimi).

Nga shenjat e kësaj nate janë: qetësia e saj, lindja e diellit në mënyrë të qartë dhe me rreze jo të forta dhe qetësia e brendshme shpirtërore e besimtarit. Allahu

i Madhëruar thotë për këtë natë: “**Paqe është ajo deri në lindjen e agimit**” (El Kadër, 5)

Ibadeti në këtë natë

Siç u përmend edhe më lart në këtë natë pëlqehet adhurimi si për shembull: namazi, dhikri, leximi i Kuranit, sadekaja etj. Pejgamberi (alejhi selam) ka thënë: “Kush ngrihet në Natën e Kadrit (me adhurim) me besim tek Allahu dhe e llogarit shpërblimin të Ai, i falen atij gjynahet e bëra” (Transmeton Buhariu).

Aishja një ditë ka pyetur Pejgamberi (alejhi selam): “O i dërguari Allahut! Çfarë të them në Natën e Kadrit po e qëllova?” – ai u përgjigj: “Thuaj: “Allahumme Inneke Afuvvun tuhibul Afve fa'fu anni”. Që do të thotë: “O Allah ti je Falës dhe e do faljen, më fal mua” (Transmeton Ahmed).

Rëndësi ka që besimtarin kjo natë ta arrijë duke bërë adhurime shumë, por edhe duke u lutur shumë, pasi në këtë natën caktohen dhe fatet e njerëzve.

AGJËRIMI I GJASHTË DITËVE TË MUAJIT SHEVAL

Nga punët e pëlqyera pas këtij muaji të begatë është përcjellja e tij me gjashtë ditë agjërime në muajin pasardhës. Kjo mund të kryhet menjëherë pas muajit të Ramazanit ose përgjatë muajit, gjashtë ditë një pas një ose të ndara. Pejgamberi (alejhi selam) ka thënë: “Kush agjëron muajin e Ramazanit dhe e përcjell më pas atë me gjashtë ditë nga muaji Sheval është sikur ka agjëruar gjithë jetën” (Transmeton Muslimi).

Kur Ramazani neglizhohet

Nga hoxhë Valdet Kamberi

Një pjesë e shoqërisë kanë zgjedhur që t'i përkushtohen në këtë muaj të bekuar televizorit e kompjuterit, rrjeteve sociale si facebook, twitter etj., ndërsa qoftë edhe një natë të vetme nuk i mbyllin këto mjete që ia lodhin dhe ia skuqin sytë, për t'u freskuar me abdes e namaz nate, që do t'ia hapte gjoksin e pushonte sytë. Hap televizorin dhe shikon seriale të ndryshme, filma etj, sikur të mos ishte për të Ramazan! Nuk hapë as mus'hafin e as nuk falet natën, sikur të mos kishte Ramazan për atë. Sa hap e mbyllë sytë ikën Ramazani dhe e dëgjon duke thënë: po shpejt ka kaluar ky Ramazan. Mirë, na trego pse të të pres ty Ramazani kur ti nuk e shfrytëzon atë, pse mërzhitesh për mysafirin që nuk i ke bërë asnjë nder, pse e pse?! A je mashtrore i vetes ti?! A logjikon ti! A di të dallosh të mirën nga e keqja?! Pse ke qëndruar 30 ditë kot, kur ti nuk je krijuar të qëndrosh kot, por për të adhuruar Allahun e Lartësuar?! Shumë njerëz kanë shpresuar të arrijnë këtë Ramazan, por iu janë lidhur këmbët dhe kanë kaluar në botën tjetër. Pse ia lidh vetes

këmbet duke qenë gjallë?! A thua a do ta prisnin ata Ramazanin sikurse ti apo do ta shfrytëzonin atë në maksimum? Po t'i sikur të ishte në vendin e tyre si do të veprime? Pse nuk ndalesh e të mendosh se një ditë do te vdesësh edhe ti si gjithë të tjerët? Pse nuk e pyet veten a je bërë gati për udhëtimin e gjatë? Pse nuk e pyet veten a ke më shumë punë dhe fjalë të mira apo te këqia? Pse nuk e pyete veten, a thua pse këta njerëz mundohen më shumë gjatë muajit të Ramazanit?

Shfrytëzoje këtë Ramazan sepse ndoshta mund të jetë i fundit. Shfrytëzoje këtë rast të artë që të është dhënë nga Allahu i Lartësuar. Shfrytëzoje para se të pendoresh, kur nuk do të bëjë më dobi asgjë. Mblidhi forcat dhe vendos të ndryshosh për të mire dhe të kapësh këto ditë të mbetura të Ramazanit. Ende ka kohë, mëshiroje veten dhe nxito në punë të mira. Kapu fort pas karvanit të të penduarve dhe mos harro se dyert e e pendimit jane hapur për çdo njeri. O Allahu ynë! Bëje këtë Ramazan muaj ndryshimi për ne, një shans për të shtuar veprat e mira dhe largim nga punët e

Ramazan / Disa nga dobitë shpirtërore të agjërimit

Nga hoxhë Justinian Topulli

“O ju që keni besuar! Agjërimi ju është bërë obligim siç qe bërë obligim edhe për ata që ishin para jush me qëllim që të mund të bëheni të devotshëm (të përkushtuar).” (Sure El-bekare, 183)

Devotshmëri në gjuhën fetare do të thotë të ruhesh nga gjynahet dhe të kryesh detyrimet. Agjërimi e kryen këtë mision, sepse gjynahet janë dy llojesh: nganjëri lloji gjynaheve mund të largohesh si rezultat i aktivitetit mendor, siç është pija alkoolike, bixhozi, vjedhja, mashtrimi... etj. Tek ky lloj i gjynaheve bën dobi këshilla, premtimi për shpërblimin që ka ai që i lë ato dhe dënimin që merr ai i cili nuk i lë, në këtë botë dhe në tjetrën.

Ndërsa lloji tjetër i gjynaheve vjen si pasojë e shkaqeve natyrore, siç është zemërimi, epshi natyror i cili është i vështirë të lihet vetëm me anë të mendjes, ndaj dhe Allahu bëri e agjërimin një mjet për tu ruajtur prej këtyre gjynaheve. Kjo sepse agjërimi e vë në baraspeshë këtë forcë natyrore e cila të shtyn drejt këtyre gjynaheve, dhe kështu myslimani ngrihet mbi poshtërsitë e kësaj bote materiale në botën e lartë shpirtërore, kështu pra agjërimi është një mjet që të bën të krahasueshëm me engjëjt dhe të largon nga cilësitë shtazarake.

Tek agjërimi do të gjejmë mbrojtje për të mos rënë në gjynahe, mbrojtje nga ndëshkimi në botën tjetër, mbrojtje nga sëmundjet dhe pasojat negative që lënë abuzimet në shijimin e kënaqësive trupore.

Njerëzit e pa fe në përgjithësi i japin përparësi kënaqësive trupore: ushqimit, pijeve alkoolike, grave, lojërave dhe muzikës. Të gjitha këto i japin një energji shtazarake trupit të njeriut dhe për rrjedhim forcohen edhe ndjenjat epshore dhe kafshërore tek ai dhe mbizotërojnë mbi forcën logjike dhe shpirtërore. Për këtë arsye fetë e ardhura nga Allahu kanë urdhëruar agjërimin, sepse agjërimi i rafinon dhe i edukon këto forca dhe energji duke e ndaluar njeriun të tejkalojë marrjen e tyre dhe si rezultat vendosjen e baraspeshës së domosdoshme ndërmjet trupit dhe shpirtit, baraspeshë të cilën Islami e ka ruajtur në të gjitha urdhëresat e tij.

Agjëruesi nuk bën gjë tjetër vetëm se braktis të ngrënë, të pirë dhe epshin e tij për hir të Atij që adhuron, kjo do të thotë të braktisë gjërat e dashura dhe të këndshme të trupit, dhe shijen që ato të japin, për hir të dashurisë ndaj Allahut dhe kënaqësisë së Tij, kjo është një e

fshehtë ndërmjet njeriut dhe Zotit të cilën askush nuk mund ta dijë përveç tyre. Njerëzit mund të qëllojnë që ta shohin një njeri që agjëron; që nuk ha, nuk pi dhe nuk kryen asgjë nga ato që e prishin agjërimin, por që ky njeri e ka lënë ushqimin, pijen dhe epshin e tij për hir të Atij që adhuron; kjo është diçka që nuk mund ta shohë asnjë prej njerëzve, dhe pikërisht ky është realiteti i agjërimit.

Agjërimi ka tre nivele: agjërimi i përgjithshëm, agjërimi i veçantë dhe agjërimi tepër i veçantë. Për sa i përket agjërimit të përgjithshëm ai kryhet duke ndaluar trupin të ushqehet si dhe të kryej aktin epshor. Agjërimi i veçantë kryhet duke ndaluar shikimin, dëgjimin, gjuhën, dorën, këmbën dhe të gjitha organet e trupit që të mos kryejnë gjynahe.

Agjërimi tepër i veçantë është agjërimi i zemrës dhe i mendjes nga çdo pasion i ulët, dhe çdo mendimi të keq që të largon nga Allahu, ai është gjithashtu; largimi me shpirt nga kjo botë dhe veçim me Allahun.

Disa nga rregullat që duhet të kihet parasysh gjatë agjërimit të veçantë është: ruajtja e shikimit nga gjërat e ndaluara, përmbajtja e gjuhës në nxjerrjen e fjalëve të shëmtuara dhe të pahijshme, si dhe fjalëve të padobishme dhe në fund; ruajtja e të gjithë pjesëve të tjera të trupit nga çdo gjë e papëlqyeshme. I dërguari i Allahut (bekimi i Zotit qoftë mbi të) ka thënë: *“Ai njeri i cili nuk i lë fjalët e këqija dhe të vepruarit me to, Allahu nuk ka nevojë që ky njeri të lërë të ngrënë dhe të pirë”* (Transmeton Buhari 1903).

“E sa prej atyre që agjërojnë nuk përfitojnë prej agjërimit të tyre vetëm se uri dhe etje!” (Transmeton Ahmedi 8639).

Vetvetiu kuptohet se agjërimi e humb vlerën edukativo-shpirtërore nëse njeriu nuk tërhiqet nga dëfrimet, madje edhe në mendime. Kjo mund të duket tepër e vështirë në sytë e njerëzve që nuk agjërojnë, por përvoja shekullore tregon se besimtarët e vërtetë gjatë agjërimit të Ramazanit e fitojnë një aftësi të tillë.

Njerëzit që jepen pas adhurimit kanë konstatuar se dëshira për të plotësuar kënaqësitë trupore natyrore e pengon përsosmërinë shpirtërore të njeriut. Që trupit t'i nënshtrohet shpirtit ai duhet t'i shmanget fuqisë trupore dhe kështu atij i jepet mundësia për shtimin e fuqisë shpirtërore. Është konstatuar se në këtë drejtim nuk ka asgjë më efikase sesa uria, etja, largimi nga epshi, kontrolli i gjuhës, zemrës, mendimeve dhe organeve të

tjera. Një nga mënyrat për përsosjen e njeriut është edhe nënshtrimi që duhet t'i bësh natyrës shtazarake që shfaqet tek njeriu; nënshtrim ndaj logjikës dhe shpirtit. Natyra e njeriut ndonjëherë ndodhet në situata rebelimi ndaj dhe ka nevojë për ushtrime të ashpra, siç është agjërimi, për të mposhtur epshet e veta. Nëse njeriu gabon, pendimi dhe lodhja që vinë prej agjërimit e ndihmojnë atë për pastrimin e shpirtit dhe i forcojnë atij vendosmërinë për të mos i përsëritur gabimet e tij.

Një rregull tjetër që duhet pasur parasysh gjatë agjërimit është edhe mos ngrënia e tepërt gjatë natës, por mjafton që njeriu të hajë aq sa i nevojitet dhe të mos e teprojë. Për shumë njerëz muaji i Ramazanit është muaji i netëve ku hahet dhe pihet pa karar, gatuhet dhe shpenzohet për ushqim ajo që nuk bëhet edhe në muajt e tjerë! Këta njerëz nuk e kanë kuptuar siç duhet thelbin e agjërimit, ndaj për një gjë të tillë duhet tu hiqet vërejtje. Gjatë agjërimit njeriu ndryshon orarin e të ngrënit dhe kjo nuk do të thotë se ai ka nevojë të ushqehet më tepër sesa në muajt e tjerë. Trupi njeriut në çdo kohë ka nevojë për të njëjtën sasi ushqimi, dhe muaji i Ramazanit nuk bën përjashtim në këtë drejtim. Duhet ditur gjithashtu se ushqimi i tepërt gjatë natës është i dëmshëm si për trupin ashtu edhe për gjendjen shpirtërore të njeriut, nëse njeriu tejkopet gjatë iftarit atëherë ai do të rëndohet për kryerjen e adhurimit gjatë natës, dhe nëse ai gjithashtu tejkopet në kohën e syfyrit, ai do të rëndohet për orët që vinë më pas. Ushqimi i tepërt shkakton dembelizëm, dhe largim nga përmendja e Allahut, dhe çështje më e rëndësishme ai nuk të lë të kuptosh dhe të ndjesh një nga qëllimet e agjërimit, i cili është të provosh shijen e urisë dhe të etjes, e pra ushqimi i tepërt e humbet këtë urtësi.

Nuk është e vërtetë se agjërimi në zonat e ftohta është në kundërshtim me kërkesat e shëndetit të njeriut. Vrojtimet biologjike tregojnë se egërsirat praktikisht nuk kanë asgjë, e veçanërisht kur bie dëborë, ato flenë, ose në ndonjë mënyrë tjetër e kalojnë kohën e vet duke agjëruar, dhe kështu në pranverë ato paraqiten të përmirësuar. E njëjta gjë vlen edhe për drunjtë, të cilët gjatë dimrit



krejtësisht i bien gjethet dhe flenë, pa i ujtur, mirëpo pas disa muaj agjërimi ata përtërihen në pranverë dhe bëhen më të fuqishëm se më parë. Në realitet si të gjitha organet jetësore tek njeriu, edhe organet e tretjes gjithashtu kanë nevojë për pushim, agjërimi është një metodë e mirë për këtë gjë. Mjekësia bashkëkohore në të gjitha shtetet e perëndimit i mjekon disa sëmundje, veçanërisht sëmundjet kronike, me anë të një periudhe të shkurtër apo të gjatë të agjërimit. Në fund duhet thënë se pavarësisht nga vlerat e dobitë trupore dhe materiale që ka agjërimi, prapë se prapë në thelb agjërimi është një detyrë fetare, ushtrimi shpirtëror i të cilit e afron njeriun te Allahu. Kushdo që agjëron në bazë të porosisë së mjekut ose për ndonjë shkak tjetër të kësaj bote, agjërimi në fjalë nuk i pranohet si adhurim fetar.

O mysliman! Mos harro ky është muaji që ti më tepër duhet t'i përkushtohesh punëve të mira, harroji për një çast lodhjet dhe punët e kësaj bote, që nuk mbarojnë kurrë dhe përkushtoj Zotit tënd që kaq shumë të do dhe të mëshiron.

Nëse nuk falesh fillo të falesh në këtë muaj të pesta kohët dhe kurrë mos i lë ato!

Nëse falesh atëherë shtoji faljet e pëlqyera gjatë ditës dhe natës!

Jep zekatin nëse ke mundësi dhe shtoji lëmoshat për nevojtarët, veçanërisht për të afërmit dhe besimtarët, por nëse nuk ke bëj çka mundesh sepse dyert e sevapeve nuk janë të hapura vetëm për dhënien e parave.

Lexoje Kuranin në këtë muaj, ose qoftë edhe një pjesë të tij, sepse Kurani zbriti në këtë muaj të bekuar dhe ky është muaji i Kuranit!

Lexo libra fetarë dhe lëri mënjanë për ca kohë gazetatat dhe revistat, televizionin dhe radion sepse ky Ramazan ikën dhe nuk kthehet më!

O njeri! Shpirti yt ka nevojë për pranverë dhe gjallëri dhe Ramazani është stina e tij!

A.M.B.C

ALBANIAN MUSLIM BUSINESS CENTRE




www.lidhjatregtareve.com



PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e Lindjes!



Jeni të mirëpritur!


Në dyqanin tonë do të gjeni:

- Produkte të firmës "Phenomenal": vaj të farës së zezë (Habbe Seuda) etj.
- Vajra bimore të firmës "Tact" (mbi 70 lloje bimësh)
- Mjaltë nga lulja e farës së zezë, mjaltë me polen, mjaltë me qumësht blete, mjaltë sidri, etj.
- Hurma arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
- Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe shampo
- Vajra el -Bedil, përzierje vajore kundër rënies së flokut
- Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojllojshme
- Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
- Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
- Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar.
- Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë xhamisë
"Dine Hoxha", Tiranë

Cel: 0672812607 / 0672821589

LIBRI "UDHËRRËFYESI ISLAM"



Libri "Udhërrëfyesi Islam" është një manual i domosdoshëm për të gjithë ata që dëshirojnë të pajisen me njohuri të përmbledhura rreth doktrinës islame, rreth bazave të Imanit (besimit) dhe të Islamit. Ky libër dallohet për metodologjinë e tij të thjeshtë dhe të mirërenditur dhe për gjuhën e tij të kuptueshme. Nisur nga eksperiencia e

gjatë në mësimdhënie dhe në aktivitetin e thirrjes islame, botuesi i këtij libri, Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë, përmes stafit të studimeve dhe hulumtimeve, ka arritur të paraqesë një Islam të thjeshtë dhe të kuptueshëm bazuar mbi ajetet kuranore, traditën profetike dhe qëndrimet e dijetarëve të mëdhenj të Islamit. Në këtë libër do të gjeni ilustrime

me foto të faljes së namazit, si dhe disa sure të shkurtra të Kuranit Famëlartë në gjuhën arabe, shqipe dhe të shqipëruara me shkronja latine.

Çdo kapitull shoqërohet në fund të tij me disa pyetje të cilat masin nivelin e përthithjes së tij nga nxënësit. Në fund ky libër shoqërohet edhe me një fjalorth të termave arabisht të përdorura në të.